



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
- AUTORITETI I KONKURENCËS -
KOMISIONI I KONKURENCËS

V E N D I M

Nr. 448 , Datë 23.01.2017

“Për revokimin e pjesshëm të Vendimit Nr. 443, datë 30.11.2016 të Komisionit të Konkurrencës “Për masat dhe detyrime për ndërmarrjet e sigurimit dhe disa rekomandime për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare mbi rivendosjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Koço BROKA	Anëtar
Znj.	Iva ZAJMI	Anëtar
Z.	Eduard YPI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23.01.2017 ,shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Revokimi i pjesshëm i Vendimit Nr. 443, datë 30.11.2016 të Komisionit të Konkurrencës “Për masat dhe detyrime për ndërmarrjet e sigurimit dhe disa rekomandime për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare mbi rivendosjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”

Baza Ligjore: Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, neni 136; Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, gërma d, dhe neni 46.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Ankimit Administrativ të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për ndryshimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 443, datë 30.11.2016,

VËREN SE :

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 443, datë 30.11.2016 “Për masat dhe detyrime për

ndërmarrjet e sigurimit dhe disa rekomandime për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare mbi rivendosjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”, në dispozitivin e tij, pika II, i është drejtuar Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, dhe i rekomandon atij (Komisionit) të detyrojë AMF për marrjen e masave për të siguruar konkurrencën e lirë dhe efektive në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta (MTPL), nëpërmjet nxjerrjes së akteve nënligjore:

- a. Zbatimin e plotë të sistemit Bonus/Malus për sigurimin e detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta duke diferencuar primet e sigurimit të të siguruarve sipas historikut të dëmeve;
- b. Dëmshpërblimin e drejtpërdrejtë për palët e siguruar që do të rriste ndjeshëm konkurrencën mes shoqërive të sigurimeve.

Autoriteti i Konkurrencës, bazuar në nenin 70, pika 2 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, për arsye të interesit të përgjithshëm ekonomik ka vlerësuar barrierat rregulluese të konkurrencës në tregun përkatës të sigurimit të detyrueshëm motorik dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse, të cilat kanë qënë konsistente dhe të vazhdueshme kundrejt AMF në vite.

Përkatësisht me vendimet:

- Nr. 49, datë 21.03.2007, “Për disa rekomandime të ndryshimeve në disa akte normative në fushën e sigurimeve”;
- Nr. 247, datë 09.10.2012 “Për disa rekomandime ndaj AMF në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta”;
- Nr. 254, datë 06.12.2012 “Për disa rekomandime ndaj AMF në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta”;
- Nr. 269, datë 18.02.2013 Për disa rekomandime ndaj AMF në tregun e policës së sigurimit kufitar”;
- Nr. 325 datë 30.07.2014 “Për disa rekomandime ndaj AMF për nxitjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”,

Komisioni i Konkurrencës, nëpërmjet dhënies së këtyre rekomandimeve për AMF ka synuar dhe kërkuar zbatimin e masave në tregun e rregulluar të sigurimit të detyrueshëm motorik, të cilat do të mundësonin zhvillimin e konkurrencës së lire dhe efektive.

Pavarësisht numrit të vendimeve dhe dhëna në vite për AMF, Autoriteti i Konkurrencës nuk ka gjetur vullnetin për bashkëpunim të rregullatorit AMF, për vënien e tregut përkatës në kushtet e konkurrencës së lirë dhe efektive.

Për sa më sipër, në situatën e ndodhur, Autoriteti i Konkurrencës i rekomandoi Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të detyrojë AMF për marrjen e masave për të siguruar konkurrencën e lirë dhe efektive në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta (MTPL), nëpërmjet nxjerrjes së akteve nënligjore të sipërcituara, përkatësisht në pikat (a) dhe (b), pika II, të Vendimit Nr. 443, datë 30.11.2016.

Në lidhje me rekomandimin e parë, gërma (a) e pikës II të Vendimit Nr. 443, datë 30.11.2016, Autoriteti i Konkurrencës argumenton, se implementimi i sistemit Bonus/Malus për sigurimin e detyrueshëm motorik duke diferencuar primet e sigurimit të të siguruarve sipas historikut të dëmeve, është propozuar nga Komisioni i Konkurrencës, që me Vendimin nr.247, datë 09.10.2012 “ Për disa rekomandime ndaj AMF në

tregun e sigurimeve të detyrueshme motorike ndaj palëve të treta”.

Megjithëse kanë kaluar më shumë se 4 vite, nga dhënia e këtij Vendimi, situata në tregun përkatës është e njëjtë, dhe sistemi Bonus/Malus nuk është bërë efektiv ende.

Kjo duket qartë edhe në shkresën nr. 2853/2 prot. të datës 23.12.2016 që AMF i drejton AK, ku ajo pranon që “[...] sistemi Bonus/Malus teknikisht do fillojë të zbatohet menjëherë, pas hyrjes në fuqi të amendimeve të ligjit, por efektet e sistemit, do të vërehen, një vit pas hyrjes në fuqi të tij”.

Vënia në funksionim e këtij sistemi, dhe rëndësia e tij në tregun përkatës, rezulton edhe nga vetë Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, datë 15.12.2016, “Për vlerësimin e veprimtarisë së AMF për vitin 2015”, ku ai (Kuvendi) i ka kërkuar nga AMF të angazhohet midis të tjerave, edhe në këtë drejtim:

- Të verifikohet algoritmi i serverit dhe sistemi i IT, në lidhje me sistemin e shitjes së gjithë tregut, në përdorim të brokerit, i cili tregton TPL, kartonin jeshil dhe kufitare, **për të siguruar konkurrencë të lirë dhe pa pengesa për shkak të këtij algoritmi;**

Në lidhje me rekomandimin e dytë gërma (b) e pikës II të Vendimit Nr. 443, datë për dëmshpërblimin e drejtpërdrejtë, Autoriteti i Konkurrencës argumenton, se AMF-ja pavarësisht nga sa sanksionohet në nenin 11 të ligjit Nr. 10076, datë 12.02.2009 “Mbi sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe respektimi i këtij rregulli i është rekomanduar në të njëjtën kohë edhe AMF me vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 325 datë 30.07.2014 “Për disa rekomandime ndaj AMF për nxitjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”, në projektligjin e propozuar, prej saj, ajo (AMF) e ka parashikuar dëmshpërblimin e drejtpërdrejtë vetëm për dëme në vlerë modeste deri në 100.000 lekë.

Autoriteti i Konkurrencës, argumenton se nga procesi hetimor, që ai ka realizuar në këtë treg, ka rezultuar se kanë qënë vetë shoqëritë e sigurimeve të cilat kanë marrë përsipër angazhimin për sigurimin e drejtpërdrejtë për pagesën e dëmeve të kryhet nga ana e shoqërive ku është siguruar mjete motorik, konform rregullimit të parashikuar shprehimisht në nenin 11 të ligjit nr. 10076 datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Ky angazhim i ndërmarrjeve është marre parasysh nga ana e Komisionit të Konkurrencës, edhe në Vendimin Nr. 324, datë 30.07.2014 “Për marrjen e masave dhe detyrimeve nga ana e shoqërive të sigurimit për rikthimin e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta” në të cilin trajtimi i drejtpërdrejtë i dëmit është rekomanduar për të gjitha dëmet pavarësisht nga vlerat e dëmeve.

Për sa më sipër Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 46 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, vlerëson se kërkesa e AMF-së për revokimin e pjesshëm të Vendimit Nr. 443, datë 30.11.2016 të Komisionit të Konkurrencës, në pikën II të tij, nuk përmbush asnjë nga kriteret e përcaktuara për revokim të parashikuar shprehimisht në këtë ligj.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, gërma d, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e Ankimit Administrativ të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për ndryshimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës me shkresën 2853/2, datë 23.12.2016.
2. Lënien në fuqi të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 443, datë 30.11.2016 “Për masat dhe detyrime për ndërmarrjet e sigurimit dhe disa rekomandime për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare mbi rivendosjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”.
3. Risjelljen në vëmendje të rekomandimeve për Komisionin e Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, që të detyrojë AMF, për vitin 2017 të nxjerre aktet e mëposhtme nënligjore, në lidhje me:
 - a. Zbatimin e plotë të sistemit Bonus/Malus për sigurimin e detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta duke diferencuar primet e sigurimit të të siguruarve sipas historikut të dëmeve, për të siguruar konkurrencë të lirë dhe efektive në treg, ashtu siç e kërkon Rezoluta e Kuvendit, datë 15.12.2016 “Për veprimtarinë e AMF për vitin 2015”.
 - b. Dëmshpërblimin e drejtpërdrejtë për palët e siguruar, për të gjitha dëmet, në funksion të përmbushjes së kërkesave të nenit 11 të ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Mbi sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, si një zgjidhje që do të rriste ndjeshëm konkurrencën mes shoqërive të sigurimeve.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e këtij vendimi Komisionit për Ekonomi dhe Financa në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë si dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare si dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS